

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 21.10.2024*

**21.10.2024  
Ora, 17:12**

***RENDI I DITËS***

**Projektvendimi “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë vendit dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve” (vijon).**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

• **Komisioni Rregullator:**

- |            |       |                              |
|------------|-------|------------------------------|
| • Ilirjana | NANO  | Kryetar                      |
| • Arens    | ÇELA  | Anëtar                       |
| • Dritan   | ÇAKA  | Anëtar                       |
| • Helga    | VUKAJ | Anëtar                       |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar                       |
| • Stafi    | KQZ   | Jona Josifi, Elona Demollari |

**Parti Politike: PSSH (E. Xhina)**

**OJQ: KRIIK**

**Znj. I. Nano:** Përshëndetje! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar ditën e sotme në orën 17:00. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, zyrtarët e administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësues të partive politike, përfaqësues të shoqërive civile dhe mediat. Sikundër jeni në dijeni në mbledhjen e ditës së shtunë, mbledhja u shty duke i lënë administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve disa detyra për të bërë disa plotësime në draft nisur nga diskutimet e gjëra që u zhvilluan në mbledhjen e dy ditëve, ditën e premte dhe ditën e shtunë. Nga ana e administratës së Komisionit

**Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 21.10.2024*

Qendror të Zgjedhjeve, përkatësisht nga ana e Sekretares së Përgjithshme, na ka mbërritur në emaillet tona në orën 14:00, një draft i riparë. Nëse mundeni zonja Josifi të na thoni shkurtimisht çfarë përfaqëson ky draft, pa hyrë në detaje, por le të themi nëse ka akomoduar disa nga ato diskutime që ne kemi bërë deri tani.

**Znj. J. Josifi:** Po faleminderit! Sikurse keni marrë dijeni, po ashtu edhe organizatat e shoqërisë civile dhe partitë politike, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve duke marrë në konsideratë seancën e zhvilluar ditën e premte dhe ditën e shtunë ka vendosur të tërheqë propozimin që kishte përcjellë për shqyrtimin dhe në vlerësimin tuaj për të na lejuar që të mund të akomodonim disa nga sugjerimet dhe rekomandimet që na erdhën kryesisht ditën e premte në pjesën e parë të seancës dhe ka vendosur të risjellë një propozim të ri të ripunuar përpara jush që vjen sërish si projektvendim “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe përgatitjen e listës së këtyre zgjedhësve”. Në vija të përgjithshme unë po ndalem vetëm te ndryshimet nga njëri projektakt në këtë projektakt që keni sot përpara jush.

**Znj. I. Nano:** Ndjesë pa dashur t’ju ndërpres, në fakt janë jo pak ndryshime mesa shoh! Mesa kemi mundur t’i hedhim një sy të shpejtë. Janë jo pak ndryshime!

**Znj. J. Josifi:** Po ka dokumenta mbështetës, ka një lidhje të rregullave të përgjithshme të funksionimit të platformës të paraqitur në mënyrë grafike, me hapa për zgjedhësit. Jemi përpjekur të akomodojmë çështjen e verifikimit të identitetit të zgjedhësit gjatë regjistrimit. Ashtu sikundër në diskutimet e bëra për vlefshmërinë ose jo të dokumentit që kërkohet gjatë regjistrimit, kështu që mbetet në vlerësimin tuaj në fakt pranë jush ky projektvendim është përcjellë në orën 14:00, siç ju e thatë,

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 21.10.2024*

ndërkohë partive politike ju është përcjellë në orën 16:00, sepse kishim disa materiale siç edhe ju e thatë. Është prekur gjithashtu edhe pjesa e ...

**Znj. I. Nano:** Shoqërisë civile kur ju është dërguar?

**Znj. J. Josifi:** Në orën 14:00, në të njejtën kohë...


**Znj. I. Nano:** Subjekteve politike, kur ju është dërguar një orë më vonë?

**Znj. J. Josifi:** Në orën 16:00! Është prekur edhe pjesa ku lidhet me auditët teknikienë dhe monitorimin e veprimeve të ndjekura nga KQZ-ja gjatë procesit të regjistrimit.

**Znj. I. Nano:** Dakord! Faleminderit. Nga partitë politike, kemi vetëm zonjën Xhina këtu, përfaqësuese. Zonja Xhina!

**Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PSSH:** Faleminderit zonja Kryetare. Siç u relatua pak më parë në orën 16:16 në adresën time të emailit ka ardhur njoftimi lidhur me aktin. Janë tre akte që përbëhen nga projektvendimi, relacioni dhe një aneks dhe janë voluminoz në përmbajtjen e tyre. Koha që erdhën aktet me kohën e orarit të takimit të mbledhjes tonë është shumë e afërt dhe shumë e shkurtër dhe natyrisht nuk të jep kohën e mundur për të shqyrtuar përmbajtjen e këtyre akteve. Për të parë qartësisht si janë adresuar, shqetësimet sugjerimet dhe rekomandimet të dala nga mbledhja e mëparshme. Në këto kushte për një trajtim sa më efektiv të aktiti dhe për dhënien e mendimeve të pjekura në këtë çështje kaq të rëndësishme, unë do të kërkoja pa krijuar as edhe një lloj shqetësimi pranë jush, që të na jepej koha e duhur për tu

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 21.10.2024*

njohur me përmbajtjen e tyre që dhe ne të shprehemi lidhur me çështjet që janë adresuar në këto akte. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit zonja Xhina! Kolegë, si mendoni! Mund të merret një kohë po të mos shkojë shumë gjatë, se jemi duke bërë ditë pas dite nga një mbledhje që të mos rrezikojmë dhe proceset e tjera që zhvillohen. Nuk e di nëse do të ishte e pranueshme për ditën e nesërme, do të jetë e mjaftueshme koha për ju! Presim dhe nga subjekte të tjera politike që kanë qenë të pranishëm këto ditë. Ndoshta janë në pamundësi, nuk kanë ardhur sot këtu.

**Z. M. Çakaj:** Për ne dakord është.

**Znj. I. Nano:** Dakord! Orën do ta njoftojmë me email zyrtar. Jo më vonë se nesër. Atëherë edhe ju që jeni këtu, zonja Xhina, por do t'i lutesha edhe subjekteve të tjera që janë njoftuar me email, mundësisht edhe një email tjetër, nëse do të jetë e mundur të kenë mendime paraprakisht, se zonja Xhina dhe Zoti Nuri në përgjithësi janë në seancë. Do të njoftoheni me email për orarin e zhvillimit të mbledhjes, ditën e nesërme. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

